



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:095319
Datë: 06.09.2023
Numri i dokumentit: 04651006

CP.nr.238/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes kryetarit Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesionale Valbona Abdylit, në lëndën përbarimore të kreditorit Sh. Sh.-H. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Malsore Halili avokate nga Vitia, kundër debitorit Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Arsimit në Gjilan, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë dhe shpërblimin jubilar, sipas dokumentit përbarimor, aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.215/2020, të datës 03.02.2021, jashtë seance gjyqësore, në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), më datë 06.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Urdhërohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Thesari në Prishtinë që mjetet monetare nga xhirollogaria e debitorit Komuna e Gjilanit, kompensimin e ushqimit në punë, në shumë prej 826.00 euro, kompensimin shpërblimit jubilar shumë prej 210.50 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 259 euro, shpenzimeve të procedurës përbarimore, shumë prej 186 euro, apo shuma e përgjithshme **1,481.50 euro**, t'i bartet të autorizuarit të kreditorit, av Malsore Halili, në llogarinë rrjedhëse me nr. të xhirollogarisë: në NLB Bank, pasi që aktvendimi mbi caktimin e përbarimit CP.nr.238/23 i datës 19.07.2023 është bërë i ekzekutueshëm nga data 31.08.2023 në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

II. Pika I e këtij dispozitivi e ka efektin e aktvendimit mbi caktimin e përbarimit me të cilin është caktuar ekzekutimi i kredisë në të holla të debitorit dhe kalimi i saj për arkëtim në dobi të kreditorit në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

III. Aktvendimi i dorëzohet palëve ndërgjyqësore, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave-Thesarit në Prishtinë, ndërsa një ekzemplar mbetet në lëndë.

A r s y e t i m

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, më datë 19.04.2023, ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit, lidhur me kompensimin e ushqimit ditor dhe shpërblimin jubilar, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr.215/2020, të datës 03.02.2021 dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarimore, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej **1,481.50 euro**.

Pasi që aktvendimi mbi caktimin e përmbarimit lëndor është bërë i formës së prerë nga data 31.08.2023 në kuptim të nenit 152 të LPP-së, si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L-48 (LMFPP) janë plotësuar kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e trajtuar aktvendimin në pikën I të dispozitivit si aktvendim me të cilin është caktuar ekzekutimi i kredisë në shumën monetare lëndore të debitorit në fjalë dhe kalimin e saj për arkëtimin në dobi të kreditorit në fjalë.

Sa i përket shpenzimeve në emër të procedurës kontestimore shumën prej 259 €, procedurës përmbarimore, dhe atë për përpilimin e propozimit shumën prej 156 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore për këtë propozim shumën prej 30 euro, gjykata në bazë të nenit 13.4 të LPP-së, ka vendosur që edhe këto shpenzime të procedurës të bien mbi barrën e debitorit, pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur detyrimet e parapara me dokumentin përmbarues lëndor, si dhe kreditori nuk ka dhënë shkas në krijimit e shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, pasi në nenin 14, parag. 2 të LPP-së, lidhur me nenet 143 deri 156 nga Kreu IV i po këtij ligji nuk është paraparë paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me të cilin urdhërohet banka ose ndonjë institucion tjetër përkatës, siç kemi të bëjmë me rastin konkret si në dispozitiv të këtij aktvendimi të bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPP-së, përkitazi me përmbarimin për kredinë sipas llogarisë në bankë. Arkëtimi lëndor i kredisë në të holla nga ana e subjekteve të caktuara siç kemi të bëjmë me rastin konkret, është rregulluar me nenin 40 të LMFPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.238/2023, më datë 06.09.2023

Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.